



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:130643

Datë: 28.02.2021

Numri i dokumentit: 01549067

P.nr.1011/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, procesmbajtëse Nacis Sarani, në lenden penale kundër të akuzuarit L.B., nga, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1542-15/2019 të datës 09.10.2020, pas mbajtjes së seancës fillestare, në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Beqë Shala, të akuzuarit, me date 01.02.2021 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.B., nga i atidhe nënae lindur e lindur, i lindur me datënëZvicër, trani jeton në Ferizaj, rruga “.....”, nr....., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 27.08.2020, rreth orës 23,40 në pikën e kalimit kufitar në vërmicë, i pandehuri L.B., haset duke poseduar pa autorizim substancë narkotike të llojit “Kanabis” (Marihuanë), ashtu që gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia dhe Dogana e Kosovës, në veturën e markës dhe tipit “.....”, me targa, tek ndërruesi i shpejtësive në një çantë dore janë gjetur tre (3) pakomë rizilla me mbishkrimin “OCB SLIM”, dhe një (1) grinder, kurse gjatë kontrollit në trupin e të pandehurit, në xhepin e pantallonave i është gjetur një qese plastike me substancë të dyshuar e cila sekuestrohet si substancë e dyshuar narkotike e llojit “Marihuanë”, e cila pas ekzaminimit laboratorik nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me numër referues: AKF/2020-....., të datës 24.09.2020, rezulton “Kanabis” (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) me peshë 1.08 gr,

Këso dore ka kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 38, 39 par.1 pika 1.1, 40 par. pika 1.3, 43, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, 71,72, dhe 269 par.2 të KPRK - ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME GJOBË

Në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, po që se dënimi i shqiptuar në shumë të cekur më lartë nuk mund të paguhet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20,00 euro një ditë burg, respektivisht 15 ditë burg.

Po ashtu obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 20,00 Euro, dhe në emër të mbrojtjes të viktimave shumë prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe dënimi plotësues dhe ate konfiskohet: D#1 një (1) qese plastike në brendi me substancë narkotike të llojit “Kanabis” (Marihuanë), me peshë 1,08 gr. dhe D#2 tre (3) pako me rizlla me mbishkrimin “OCB SLIM” dhe një (1) grinder, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.1542-15/2019 të datës 09.10.2020, kundër të akuzuarit L.B., nga Ferizaji, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope nga neni 269 par.2 të KP-së,

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr.1542-15/2019 të datës 09.10.2020, kundër të akuzuarit L.B., nga Ferizaji, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-ës., dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimit i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

Po ashtu propozoj që ndaj të njëjtit konform dispozitave ligjore të konfiskohet substanca narkotike dhe ate 1 qese plastike në brendi me substancë narkotike të llojit kanabis (marihuan) me peshë 1,08 gr si dhe tre pako me rizlla me mbishkrimin “OCB SLIM”, dhe një grinder.

I akuzuari L.B., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, e tërë ngjarja ka ndodhur ashtu siç është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, dua të shtoj që pranimin e fajësisë si dhe rrethanat tjera personale, moshë ime në momentin e kryerjes së veprës, pendimi im i thellë, premtimi im që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm

dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla dhe të ngjashme, si dhe që tani jam i vetë dijjshëm se nuk do kryej vepra të kësaj natyre apo të ngjashme, për shkak të pasojave të pa dëshiruara, andaj propozoj gjykatës që të gjitha këto rrethana ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 27.08.2020, rreth orës 23,40 në pikën e kalimit kufitar në vërmicë, i pandehuri L.B., haset duke poseduar pa autorizim substancë narkotike të llojin “Kanabis” (Marihuanë), ashtu që gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia dhe Dogana e Kosovës, në veturën e markës dhe tipit “.....”, me targa, tek ndërruesi i shpejtësive në një çantë dore janë gjetur tre (3) pakomë rizilla me mbishkrimin “OCB SLIM”, dhe një (1) grinder, kurse gjatë kontrollit në trupin e të pandehurit, në xhepin e pantallonave i është gjetur një qese plastike me substancë të dyshuar e cila sekuestrohet si substancë e dyshuar narkotike e llojit “Marihuanë”, e cila pas ekzaminimit laboratorik nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me numër referues: AKF/2020-..... të datës 24.09.2020, rezulton “Kanabis” (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) me peshë 1.08 gr,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuzën, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope nga neni 269 par.1 të KP-së.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 të KPRK gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të të njëjtit, gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me gjobë në lartësi prej 300 euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi konfiskimin e sendit gjykata e bazoi në kuptim të nenit 115 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1011/2020 me datë 01.02.2021

Procesmbajtësja
Nacis Sarani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.